



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M¹

Nr. 553, datë 15.7.2020

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE
TË INFORMACIONIT DHE TË LISTËS SË INFRASTRUKTURAVE
TË RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.2/2017, "Për sigurinë kibernetike", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, të cilët identifikohen për herë të parë me këtë vendim, të përcaktojnë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pikën e kontaktit, person përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
4. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike kontrollon zbatimin e masave të sigurisë nga operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

¹ Ky projektvendim është përafruar pjesërisht me direktivën (BE) 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 korrik 2016, "Lidhur me masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në BE", Numri CELEX 32016L1148, "Fletorja zyrtare" e Bashkimit Evropian Seria L

5. Vendimi nr.222, datë 26.4.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, shfuqizohet.
6. Ngarkohen Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

A large, handwritten signature in black ink, appearing to read "Braçe", is written over the typed name "ERION BRAÇE". To the left of the signature, the typed title "ZËVENDËSKRYEMINISTRI" and name "ERION BRAÇE" are printed. The signature is fluid and cursive, with some loops and variations in letter form.